



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:202837

Datë: 10.12.2020

Numri i dokumentit: 01521902

**C.nr.1005/11**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtarin Dardan Kadolli, në çështjen juridike kontestimore të paditëses-kundërpaditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat Labinot Buzuku nga Prishtina, kundër të paditurve-kundërpaditësve M. M., V. M., N. M., B. M., V. M. nga Podujeva, të cilën sipas autorizimit i përfaqëson avokat Zaim Istrefi nga Prishtina, me objekt të kontestit ndërprerje e rentës, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor publik me datë 10.12.2020 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. PJESËRISHT APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, ashtu që ndërpritet pagesa e rentës mujore për palën e paditur M. M. dhe V. M. nga data 23.05.2011, e cila ishte caktuar sipas Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Podujeve C.nr.180/2008, datë 26.01.2009.

**II. REFUZHET E PA BAZUAR** pjesa e kërkesëpadiës së paditëses Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, përmes së cilës është kërkuar ndërprerja e pagesës së rentës për N. M., B. M. dhe V. M..

**III. PJESËRISHT APROVOHET** kundërpadia e paditësve N. M., B. M. dhe V. M., ashtu që DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Suguria” që për shkak të vdekjes së bashkëshortit dhe babait të tyre – N. M. në aksidentin e datës 17.03.2008 në Prishtinë, t’ia paguaj shumat si vijon:

- Në emër të kompensimit në formë të rentës mujore, duke filluar nga data 01.07.2020, e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore t’iu paguaj shumën për secilin veç e veç nga 100€ në muaj.

**IV. DETYROHET** e paditësja – e kundër paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, që kundër paditësve t’iu paguaj kamatën për pjesën e aprovuar të kundërpadiës si për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, nga dita e marrjes së aktgjykimit datë 10.12.2020 e deri në përmbushje definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 711€, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën detyrimin të përbarimit të detyrueshëm.

## A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit me autorizim, pranë kësaj gjykate, me datë 23.05.2011, ka parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt të kontestit ndërprerje e rentës së gjykuar. Në padi ka theksuar se me Aktgjykimin C.nr. 180/2008 të paditurve, për shkak të vdekjes së bashkëshortit, përkatësisht babait, është aprovuar kërkesëpapia në shumën e përgjithshme prej 80,785181€, si dhe është gjykuar renta nga data 07.11.2008 dhe në të ardhmen, në vlerë prej 173.34 € derisa të ekzistojnë kushtet ligjore për këtë detyrim. Ka shtuar se po ashtu sipas aktgjykimit C.nr.151/2008 paditësit Xh. M. i është aprovuar kërkesëpapia në shumën prej 10884 €, të dy këto aktgjykime për kompensimin e dëmit kishin të bënin me të njëjtin aksident dhe kanë qenë të mbuluara me një polisë të sigurimit me numër 870323. Sipas përfaqësuesit të palës paditëse – kundërpaditur, sipas rregullit 3 mbi ndryshimin e rregullit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia të BQK-së, i datës 11.12.2007, kufizimi i mbulesës sigurose në rastet e vdekjes, lëndimi trupor apo dëmtimit të shëndetit, limiti i shumës sigurose është 100.000€.

Përgjatë seancave gjyqësore përfaqësuesi i paditëses ka propozuar nxjerrjen e aktgjykimit për mes të cilit të paditurve do t’iu ndërpritet pagesa e rentës, për shkakun se është arritur limiti i mbulesës sigurose, si dhe disa nga të paditurit kanë arritur moshën madhore. I njëjti përmes parashtrësës ka bërë precizimin e padisë, ashtu që ka kërkuar ndërprerjen e rentës për N. B. M., V., M., B., V. M..

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Të paditurit përmes përfaqësuesit të tyre me kohë kanë ushtruar kundërpadi ndaj këtu paditëses. Në kundërpadi është theksuar se për sa i përket të paditurve V. M. dhe M. M. nuk kontestohet kërkesëpapia lidhur me ndërprerjen e rentës mujore. Si kundërpaditës janë përfshirë N. M., B. dhe V. M., ashtu që për të njëjtit është kërkuar që mos të ndërpritet renta mujore, për arsye se me dispozitat e LMD-së dhe praktiken gjyqësore të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk ekziston limiti për kompensimin e rentës mujore në emër të fitimit të humbur, pra për këta kundërpaditës nuk janë plotësuar kushtet ligjore për ndërprerjen e saj. Është cekur se për sa i përket kundërpaditësve B. dhe V. M., janë duke e vazhduar shkollimin, së këndejmi edhe pse janë të moshës madhore iu takon pagesa e rentës, ngase si pasojë e humbjes së babait të tyre si ushqyes i vetëm i familjes iu takon e drejta në rentë, meqë të njëjtit vazhdojnë shkollimin.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Podujevë C.nr.182/2008 i datës 26.01.2009; aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Podujevë C.nr.151/2008 i datës 26.01.2009; konfirmimi i sigurimit i datës 02.06.2008; pasqyra nga trusti pensional; ekstraktet e lindjes në emër të N., B., V., V., M. M.; vërtetimi nga shkolla e Lartë Teknike “Fan Noli” në Podujevë datë 01.04.2009; ekspertiza aktuaristike datë 24.06.2020.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Përgjatë procedurës gjyqësore rezultoi të mos jetë kontestuese se caktimi i mbajtjes mujore në formë të rentës mujorë, për të paditurit M. dhe V. M. duhet të ndërpritet, këtë fakt e ka pohuar përfaqësuesi i tyre përgjatë seancës gjyqësore. Gjithashtu nuk ishte kontestues fakti se për rastin e siguruar, tashmë është arritur limit i sigurimit prej 100,000€. Për vërtetimin e këtyre fakteve, gjykata nuk do të lëshohet në vlerësimin e provave.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet nëse renta për sa i përket të paditurve-kundërpaditësve N. M., B. M. dhe V. M. duhet të ndërprite ngase është arritur limiti i sigurimit, kurse për këtë përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse kanë paraqitur argumente të ndryshme me tyre.

Gjykata gjeti se të paditurve-kundërpaditësve i është caktuar renta mujore sipas Aktgjykimit të Gjykatës Komonale në Podujevë C.nr. 180/2008 i datës 26.01.2009, ngase në aksidentin e shkaktuar me datë 17.03.2008, ka mbetur i vdekur familjari i tyre N. M.. Përmes këtij aktgjykimi, ndërgjyqësve i është caktuar renta në lartësi prej 173.34€ në muaj, duke filluar afati i pagesës nga data 07.11.2008.

Përmes vërtetimit të datës 01.04.2019 të lëshuar nga Shkolla e Mesme e Lartë “Fan Noli” në Podujevë, vërtetohet se e kundërpaditësja B. M. është nxënëse në klasën e X (dhjetë). Përmes kësaj prove vërtetohet se njëjta edhe pse ka arritur moshën madhore, vazhdon shkollimin, prandaj e drejta në kompensim në formë të rentës, do të vazhdoj përderisa vazhdon shkollimin, e më së shumti deri të arrin moshën 26 vjeçare.

Nga certifikata e lindjes L 23290190, vërtetohet fakti i lindjes së të paditurit-kundërpaditësit V. M. datë 31.10.2003. Sipas kësaj prove provohet se i njëjti nuk e ka arritur ende moshën madhore 18 vjeçare, prandaj i njëjti ka të drejtë në kompensim të mbajtjes.

Për të përcaktuar ndryshimin e rentës që do t'i takonte të paditurve-kundërpaditësve, gjykata ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë të aktuaristikës, të cilën e ka punuar ekspert Aziz Berisha. Sipas kësaj ekspertize është gjetur se si pasojë e vdekjes së bashkëshortit të N. M. dhe babait të V. dhe B. M., në aksidentin e komunikacionit të datës 17.03.2008, e drejta e kompensimit në formë të rentës i'u takon në lartësi për secilin nga 100€. Eksperti mendimin e ka bazuar në faktin se i ndjeri, me punën e tij do të kishte për të kontribuar në mbajtjen e familjarëve të tyre, ngase ai kishte qenë në marrëdhënie pune.

Gjykata ekspertizën aktuaristike e ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që ishte profesionale dhe e argumentuar, po ashtu e punuar sipas vëllimit të përcaktuar, po ashtu duke ofruar të dhëna lidhur vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Pas vlerësimit të provave të administruara dhe pohimeve të palëve ndërgjyqëse, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e pjesërisht e bazuar. Ky vlerësim mbështetet në Rregullin 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm nga autopërgjegjësia, të datës 11.12.2007. Neni 2 pika 1.3 i këtij akti rregullon se: “*Shuma maksimale e sigurimit të detyrueshme për një rast të siguruar, respektivisht shumat e detyrueshme maksimale të sigurimit, të cilat duhet të kontraktohen në sigurimin e autopërgjegjësive janë: a. Për rastin e vdekjes, lëndimit trupor dhe dëmtimet të shëndetit, për person, për autobus dhe automjete të cilat bartin mallra të rrezikshme 100,000€*”. Përgjatë procedurës nuk ka rezultuar të jetë

kontestues fakti se është arritur limiti i sigurimit prej 100,000€, prandaj me aplikimin e kësaj dispozite, është vendosur të aprovohet kërkesëpadia dhe të ndërpritet pagesa e rentës mujore për të paditurit M. dhe V. M..

Gjykata gjeti si të bazuar pretendimin e përfaqësuesit të të paditurve- kundërpaditësve, se kundërpadia duhet të aprovohet, ngase pagesa e rentës mujore në të holla për të ardhmen, nuk mund të jetë i lidhur me limitin e sigurimit. Neni 194 i Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve Gazeta Zyrtare nr.29/78 (LMD) përcakton: *Personi të cilin i vrari e ka ushqyer ose e ka ndihmuar rregullisht, si dhe ai që sipas ligjit ka pasur të drejtë të kërkojë ushqim nga i vrari ka të drejtë kompensimi të dëmit që pëson nga humbja e ushqimit ose të ndihmës. Ky dëm kompensohet me pagimin e rentës në të holla shuma e së cilës caktohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit e që nuk mund të jetë më e madhe nga ajo që do të fitonte i dëmtuari nga i vrari po të mbetej gjallë.*

Në këtë rast kontestues është arritur të vërtetohet gjendja faktike, në drejtim të konstatimit se renta të kundërpaditësve i'u është caktuar si pasojë e vdekjes së prindit dhe bashkëshortit të tyre. Prandaj me aplikimin e kësaj norme, mbi të paditurën bie obligimi i kompensimit të dëmit në formë të rentës, ngase po të ishte mos ndodhte fatkeqësia e komunikacionit, i ndjeri të siguronte të ardhura për kundërpaditësit. Nga administrimi i provave në këtë procedurë, është gjetur se kundërpaditësja e parë, N. M. ishte bashkëshortja e të ndjerit, prandaj me vdekjen tij, asaj i ka humbur mbajtja që si rregull do të realizonte nëqoftëse i ndjeri të ishte gjallë. Për këtë të paditur, paditësja nuk ka arritur të paraqiste ndonjë provë që do të dëshmonte ndonjë fakt se duhet të ndërpritet pagesa e rentës, ashtu që e njëjta të ketë themeluar ndonjë marrëdhënie pune. Kurse për sa i përket të paditurit- kundërpaditësit V. M., është vërtetuar se i njëjti ende është i mitur pra nën moshën 18 vjeçare, prandaj ende nuk janë plotësuar kushtet ligjore për ndërprerje të rentës.

Gjykata arriti në përfundim se duhet të refuzohet padia e paditëses, ndërsa të aprovohet kundërpadia e të paditurës të tretë B. M., ngase është vërtetuar se e njëjta ende pse është e moshës mbi 18 vjeçare, është nxënëse në shkollë të mesme dhe atë në klasë të dhjetë. Neni 290 par. 2 i Ligjit për Familjen i Kosovës Nr. 2004/32 përcakton: *Nëse fëmiju nuk e ka përfunduar shkollimin deri në moshën madhore, prindërit kanë detyrim të ofrojnë mbështetjen e nevojshme për të siguruar shkollimin, respektivisht edukimin në fakultet deri sa fëmiju të arrin moshën 26 vjeç*". Nga kjo norme ligjore derivon e obligimi i prindit, që për fëmijët që vazhdojnë shkollimin të ofrojnë mbajtje financiare. Rrjedhimisht, duke qenë se prindi i sajë tashmë është i ndjerë, ekziston obligimi i paditëses-kundërpaditurës që të paguaj mbajtje në formë rente, derisa të ekzistojnë kushtet ligjore.

Lidhur me pretendimet e ngritura nga përfaqësuesi i palës së paditur se në këtë çështje kontestuese, duhet të ndërpritet renta, ngase tashmë është arritur limiti i sigurimit prej 100,000€, gjykata vlerëson se pagesa e shpërblimit në formë të rentës, nuk kufizohet nga Rregulli 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm nga autopërgjegjësia, të datës 11.12.2007<sup>1</sup>. Së këndejmi, edhe pse është vërtetuar se është arritur limiti i sigurimit (fakt i pa kontestuar nga përfaqësuesi i të paditurve-kundërpaditësve), gjykata vendosi të aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, kurse në anën tjetër të aprovoj kundërpadinë.

Gjykata lidhur me kërkesën për kamatën ka vendosur ne kuptim te neneve 277 te LMD-së, sipas të cilit: *Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos*

<sup>1</sup> Në këtë mënyrë Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.264/2015, datë 09.12.2015.

*kryegjësë, edhe kamatën sipas shkallës, e cila në vendin e përmbushjes paguhet në depozimet e kursimit me të parë.*

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrë konform nenit 449 dhe 452.2 të LPK-së dhe tarifës zyrtare për përfaqësime dhe atë si në vijim: për përpilimin e kundërpadisë 156€, shpenzimet e ekspertizës financiare 150€, për 3 përfaqësime 405€ (3x135€), apo shuma e përgjithshme 711€, pasi që këto janë shpenzime proporcionale për suksesin e arritur në procesin gjyqësor ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve të kërkuara është refuzuar.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
C.nr.1005/11 datë 10.12.2020**

**Gjyqtari**

---

**Dardan Kadolli**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh , nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.